

V E N D I M
Nr.374, datë 26.7.1993

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË EKZEKUTIVE TË BURIMEVE ENERGETIKE PËR
POPULLSINË**

Me propozimin e Komisionit Qëndror për Ngrohjen e Popullsisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të krijohet Agjencia Ekzekutive e Burimeve Energetike për Popullsinë me objekt veprimtarie:

a) Ndërtimin e politikës së tregut për nevojat energetike të popullsisë, në raport me politikën e energjisë për ekonominë.

b) Ndërtimin e bilanceve për nxjerrjen e nevojave për energji për popullsinë sipas zonave klimatike, përcaktimin e mënyrës së plotësimit të këtyre nevojave duke synuar përdorimin sa më efektiv të energjiave.

c) Për caktimin e raporteve ekonomiko-financiare në përshtatje me politikat energetike si dhe zgjidhjen e problemeve në marrëdhënie me tregun e brendshëm e të jashtëm dhe strukturat përkatëse të tyre.

2. Agjencia Ekzekutive e Burimeve Energetike për Popullsinë dërgon në fund të muajit mars 1994 të jetë pranë Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, kurse pas kësaj date të kalojë pranë Komitetit Kombëtar të Energjisë.

3. Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit në bashkëpunim me Komitetin Kombëtar të Energjisë, 15 ditë pas daljes së këtij vendimi, të emërtojë kryetarin e Agjencisë dhe me propozim të tij të miratojë strukturën organizative të Agjencisë në përshtatje me objektin e veprimtarisë së saj.

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.380, datë 31.8.1992 "Për krijimin e Komisionit Qëndror për Ngrohjen e Popullsisë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi